




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-23082/20 datë:16.11.2020



Npi – 01/269 Datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2, pika (d) nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr. 020-777/3 datë: 27.10.2020, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-210, për shpalljen me interes të përgjithshëm N.K-Nr.2270-4, Z.K-Shtime. Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
Npi – 01/210 TË DATËS: 29.09.2020

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 24.11.2020, me shumicën e votave vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/210, të datës 29.09.2020, për shpallje me interes të përgjithshëm, Ngastrën Kadastrale: Nr. 2270-4; Me sipërfaqe 33220m²; Zona Kadastrale – Shtime; Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 15 vite.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj